



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.132/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit M. M , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr .704/16 të dt.06.1.2017 për shkak të veprës penale: vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë të pandehurit M. M dhe të prokurorit të shtetit Sanije Gashi Seferi me dt.08.2.2018 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri M. M i lindur me dt.12.8.1966 në fsh. B. R. K. e P , tani në fsh. N. K e P , i biri A dhe nënës Rr e gjinisë B, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 10.1.2015 në lokalitetin e tij Motel në fsh. B. K e P , pa autorizim të furnizimit ka autorizuar ka përfutur shërbime komunale përmes rrjetit të energjisë elektrike , në atë mënyrë që ditën kritike përgjatë kontrollit që kanë bërë komisioni i autorizuar i KEDS –it , distribicioni në Pejë është konstatuar se si pandehuri nga KPO ka kyçur një kabull elektrik jashtë njehsorit dhe matjes me ç’ rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëme materiale.

-me çka ka kryer veprë penale : vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 ,49 ,50,51,52, 76 dhe nenit 320 të KPRK-së.

E GJYKON :

1.Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1(një)viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

Dhe :

Me dënim burgu,

2.Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 215 euro – 15 ditë pasi që aktgjykim të merr formën e prerë.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.06.2.2017, kundër të pandehurit M. M ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.704/16 për vepër penale : vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme gjendjen e varfër ekonomike i pandehuri është mbajtës i familjes prej 5 anëtarësh, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.08.2.2018.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .